

Vendim nr. 225 datë 08.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 08.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **EMINE XHELILAJ**, përfaqësuar nga avokat Enkes Hysendhima, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3569(348), datë 06.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 8, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Emine Xhelilaj (*kërkuesja*) është një nga trashëgimtarët e R.Sh., i cili nga ana tjetër është një nga trashëgimtarët e S.Sh. Me pretendimin se ky i fundit ka qenë subjekt i shpronësimit të një prone me sipërfaqe 167,2 ha, të ndodhur në fshatin Zvërnec, komuna Qendër, Vlorë, në datën 18.07.2007 trashëgimtarët e tij, të përfaqësuar me prokurë nga shtetasi P.P., kanë vënë në lëvizje procesin e njohjes dhe kthimit të asaj prone. Pas shqyrtimit të kërkesës, përfundimisht në lidhje me të është shprehur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), e cila, me vendimin nr. 1341, datë 30.11.2011 (*vendimi nr. 1341/2011*), ka vendosur të mos i njohë dhe kthejë pronën e pretenduar trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar S.Sh.

2. Në datën 26.12.2011 në gjykatë është regjistruar një kërkesëpadi në të cilën si paditës është paraqitur shtetasi P.P. Ky i fundit, si përfaqësues me prokurë të përgjithshme të trashëgimtarëve ligjorë të S.Sh., përmes padisë ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1341/2011 të AKKP-së, duke njohur të drejtën e pronësisë në emër të subjektit të shpronësuar S.Sh. (trashëgimtarëve të tij ligjorë) për pronën të ndodhur në fshatin Zvërnec, komuna Qendër, Vlorë me kufij përkatës, si dhe kthimin fizik të saj. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3801, datë 10.04.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi P.P., ndërsa personat e tretë M.M. dhe V.M. kanë paraqitur apel kundërshtues.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2643, datë 17.12.2013, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur pranimin pjesërisht të padisë së paditësit P.P. dhe disponuar për njohjen e së drejtës së pronësisë në favor të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar S.Sh. për pronën të ndodhur në fshatin Zvërnec, komuna Qendër, Vlorë me sipërfaqe 156 ha dhe kthimin fizik të kësaj sipërfaqeje me kufijtë natyrorë përkatës, ndërsa ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit dhe personat e tretë A.H., A.D., M.M. dhe V.M., ndërsa paditësi P.P. ka paraqitur kundërrekurs.

4. Kolegj Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3569 (348), datë 06.10.2022, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shkakun se gjykatat më të ulëta nuk kanë verifikuar legjitimitimin e palëve dhe nuk kanë përcaktuar qartësisht palën paditëse që gëzon legjitimitet aktiv në këtë proces, duke vërejtur se gjykimi i çështjes është vënë në lëvizje nga shtetasi P.P. dhe është zhvilluar me pjesëmarrjen e tij si paditës, ndërsa ky shtetas nuk mund të ishte si i tillë në proces edhe pse kishte prokurë përfaqësimi nga trashëgimtarët e të ndjerit S.Sh., të cilët duhej të ishin paditës në proces.

5. Në datën 24.07.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 01.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuësës

6. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

- 6.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi shumë vite pas marrjes formë të prerë të vendimit për njohjen e së drejtës së pronës, kërkuësja, si pronare e saj, gjendet papritur përpara rifillimit nga e para të procesit gjyqësor për shkak të vendimit të Gjykatës së Lartë, megjithëse nuk ka marrë njoftim për procesin gjyqësor në atë gjykatë.
- 6.2. *Së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e njoftimit dhe parimin e kontradiktoritetit*, pasi kërkuësja nuk është njoftuar as për rekursin, as për procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Është e vërtetë se rekursi i është njoftuar mbrojtësit të caktuar nga trashëgimlënësi i saj, por se Gjykata e Lartë duhet të verifikonte nëse ai vijonte të ishte edhe përfaqësues i kërkuësës. Babai i saj ka marrë pjesë në procesin gjyqësor në shkallë të parë dhe në apel si trashëgimtar i S.Sh. dhe është përfaqësuar nga shtetasi P.P., por me vdekjen e babait ka rënë dhe prokura e lëshuar nga ai për këtë shtetas, ndaj, në këto kushte, Gjykata e Lartë duhet të kishte thirrur në gjykim si paditës të gjithë trashëgimtarët e tij, përfshirë edhe kërkuësen, por kjo nuk ka ndodhur dhe ajo nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në atë gjykatë, duke e vënë në pamundësi të paraqesë pretendimet e saj.
- 6.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private*, pasi duke prishur vendimet e gjykatave të faktit, me argumentin e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, Gjykata e Lartë i ka cenuar kërkuësës të drejtën e pronës. Ajo gjykatë është fokusuar vetëm te pjesa formale e paraqitjes së palëve nga gjykatat e faktit, çka është një lapsus vetëm në dukje, ndërsa nuk ka asnjë dyshim ose paqartësi për paditësin dhe përfaqësuesin e tij. Edhe palët e tjera ndërgjyqëse nuk kanë ngritur pretendime të tilla gjatë procesit gjyqësor, madje as në rekurs, prandaj Gjykata e Lartë nuk kishte asnjë shkak për të analizuar ndërgjyqësinë. Prishja e procesit gjyqësor për

shkaqe formale, kur ato nuk e cenojnë në thelb vendimin, nuk pajtohet me kërkesat e procesit të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

8. Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes nuk ka një rend të përcaktuar të vlerësimit të kriterëve të legjitimitimit, ashtu siç edhe mund të verifikohet (mos) përmbushja e një ose më shumë prej këtyre kriterëve në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuenin. Edhe pse kriteret e legjitimitimit kanë të njëjtën peshë në rezultatin e shqyrtimit paraprak, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, kjo nuk nënkupton se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i më shumë se një kriteri, ato të humbasin rëndësinë dhe karakterin kumulativ të tyre (*shih vendimin nr. 46, datë 12.03.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

9. Duke mbajtur në konsideratë këtë qasje, Kolegji çmon të verifikojë fillimisht kriterin paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky rregull përbën

parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka prishur vendimet e dy gjykatave më të ulëta dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë që i përket kompetenca tokësore, duke përcaktuar edhe detyrat përkatëse për gjykatën e rigjyimit në drejtim të formimit të drejtë të ndërgjyqësisë. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjyimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, për vendime të këtij lloji, përjashtimisht, Gjykata ka pranuar se ato mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në të tilla raste kërkuesi duhet të provojë se shkelja e pretenduar në rastin konkret është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pasi ajo dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual në thelb kanë të bëjnë me të drejtën e pronës, duke kundërshtuar, ajo, vendimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me mënyrën e interpretimit të ligjit procedural për sa i përket ndërgjyqësisë së formuar gjatë procesit gjyqësor, megjithëse ajo gjykatë nuk është shprehur për të drejtën e pronës që është në themel të asaj çështjeje. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkueses për të drejtën e pronës, nisur nga natyra e tyre, janë të tilla që duhet të shqyrtohen dhe sqarohen në rigjykimin e çështjes, pra në

procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë duhet të marrin përgjigje nga ato gjykata në ushtrim të juridiksionit të tyre. Në kushtet kur procedurat gjyqësore për shqyrtimin e çështjes nuk kanë përfunduar ende, Kolegji vlerëson se kërkesja ka ende mjete ligjore efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtën e pronës të pretenduar si të cenuar, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

12. Në rrethanat si më lart, verifikimi i kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të kërkueses bëhet i panevojshëm, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, ndaj, në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.